



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr./6047 Prot

Shkodër, më 31.07.2024

Lënda: Dërgohet saktësim materiali ne lidhje me projekt-vendim “Për një ndryshim në VKB nr.55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, VKB nr.60, date 28.12.2020 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit bashkiak Shkodër”, bashkëngjitur Ju dërgojmë saktësimin e materialit te percjelle per shqyrtim nga ana juaj për projekt-vendimin “Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, konkretisht;

- Tabelen nr.11
- relacionin

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt!

K R Y E T A R
BENET BECI

Me vendim delegim
Zv.KRYETARI
Ond BEJLERI.



Ishte
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2024

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri punonjësve të miratuar	Numri punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	583	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	126	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	228	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	42	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		979	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
TOTALI		999	20

Bëhet
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2024

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri punonjësve të miratuar	Numri punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	603	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	126	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	228	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	42	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		999	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
TOTALI		1,019	20

Me vendim delegimi
Zv.KRYETARI
Onid BEJLERI



KRYETAR
Benet BECI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

RELACION

Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh”, ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar; ligji nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ligji nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”; VKB nr. 54, datë 29.12.2023 “Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 ...; VKB nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026; Bashkia Shkodër paraqet për shqyrtim relacion për:

1. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve të Sektori i Emergjencave Civile, nga 3 nëpunës në 8 nëpunës duke krijuar Drejtorinë e Emergjencave Civile nga Njësi e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile që është aktualisht,
2. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake të Bashkisë Shkodër nga 39 aktualisht në 54 punonjës.

I.Kërkesa për rritjen e numrit të nëpunësve tek emergjencat civile vjen si rezultat i nevojës për të kryer shërbime cilësore, pasi në ligjin 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, në nenin 30 caktohen disa detyra shumë të rëndësishme për bashkitë në kuadër të mbrojtjes civile.

Në ndryshim nga ligji i mëparshëm nr.8756, datë 26.03.2001, “ Për emergjencat Civile”, i ndryshuar, në ligjin 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, bashkitë marrin rol kryesor në parandalimin dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, duke filluar me hartimin e tre dokumentave strategjikë siç janë a) Dokumenti i Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë, b) Dokumenti i Strategjisë së Zvoglimit të Riskut nga Fatkeqësitë dhe c) Plani Vendor I

Emergjencave Civile, deri te kryerja e investimeve parandaluese, mbrojtëse dhe reabilituese nga fatkeqësitë.

Gjithashtu në nenin 65 të këtij ligji, “Buxheti i bashkive”, sanksionon që bashkitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 përqind të totalit të buxhetit vjetor, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.

Nga raporti i konsoliduar i Agjencia Kombëtare të Mbrojtjes Civile për Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Shqipëri, qarku i Shkodrës karakterizohet nga një risk shumë i lartë nga përmbytjet dhe zjarret masive dhe bën pjesë në zonat e vendit që kanë nivel risku mesatar në të lartë nga fatkeqësitë. Vetëm në vitet 2018 dhe 2021 janë përmbytur 4593 ha sipërfaqe me kultura bujqësore, në vlerë dëmi 1,112,636,459 (një miliard, e njëqind e dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë lekë).

Edhe në fushën e emergjencave në lidhje me zjarret, bashkia Shkodër ka një situatë të rënduar, pasi vetëm gjatë vitit 2023, është ndërhyrë në 341 raste zjarresh dhe në datë 14 Qershor kemi patur një zjarr në lagjen Perash, me pasoja të rënda në pronën e qytetarëve.

Në këto kushte Struktura e Emergjencave Civile ka nevojë për staf shtesë dhe të kualifikuar, pasi veç të tjerash kjo strukturë ka detyrim ligjor vlerësimin e dëmeve që ju shkaktohen qytetarëve për jetën dhe banesat e tyre, prej fatkeqësive.

Sa me siper, Shtesa prej 5 punonjës kërkohet me qëllim realizimin e detyrave të emergjencave civile në zbatim të ligjit specifik të tij

II. Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake bazohet në faktin se Policia Bashkiake është strukturë në varësi të bashkisë, e cila angazhohet në zbatimin e detyrave që i ngarkon ligji organik për vetëqeverisjen vendore, vendimet e këshillit bashkiak, si dhe akte të tjera të nxjerra nga kryetari i bashkisë. Referuar parashikimeve të këtij ligji, Policia Bashkiake ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, në mbarëvajtjen e punëve publike, mirë administrimit të hapësirave publike në territorin e juridiksionit të saj, zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve të nxjerra nga organi përfaqësues dhe ekzekutiv i bashkisë.

Duke marrë në konsideratë rolin e saj në ndihmë të ushtrimit të funksioneve të organeve dhe strukturave të bashkisë, situatën problematike të krijuar ndër vite tashmë puna e Policisë Bashkiake Shkodër ka marrë një dimension edhe më të gjerë, ka krijuar një vijueshmëri në procese pune me procedura të standartizuara dhe sistematike që bën të domosdoshëm shtimin e numrit të punonjësve në funksion të mbarëvajtjes normale të punës dhe efektivitetit të detyrave të ushtruara nga kjo strukturë.

Konkretisht përse duhet të shtohet numri organik i strukturës së Policisë Bashkiake?

Arësyeja I:

Numri i punonjësve të PB aktualisht në vitin 2024 është 39 (5 janë roje objektit të bashkisë), referuar organikave të vitit 2002 struktura ishte 37, ndërkohë me kalimin e viteve kemi dendësi në rritje të popullsisë në qytetin Shkodër, njësinë administrative Velipojë, rritje të territorit në kilometër katror dhe në rrugë automobilistike, rritje të bizneseve të regjistruara, rritje të turizmit në të gjithë territorin duke përfshirë pikat turistike masive të Velipojës, Shirokës dhe Thethit, etj..

Me miratimin e ligjit organik nr 139/2015 “Për vetë qeverisjen Vendore” popullsia, territori, asetet e ish komunave janë bërë pjesë e Bashkisë Shkodër ndërsa strukturat e Policive Komunale janë shkurtuar duke e lënë strukturën e punonjësve të PB me vetëm 24 punonjës, deri në muajin Shtator 2023.

Për t’ju përgjigjur në kohë problematikave të qytetarëve, bashkisë si institucion dhe jo vetëm, për rendin e sigurinë publike, logjikisht duhet shtuar numri i punonjësve të PB ku në këtë numër përfshihen dhe punonjësit administrativ që nuk kryejnë funksione operacionale.

Arësyeja II:

Në ligjin e vjetër detyrat për Policinë Bashkiake ishin 12 ndërsa aktualisht ato janë mbi mbi dyfishuar duke u bërë 28 të ndara në 7 fusha, më poshtë mund të përmendim:

detyra për emergjencat civile, në fushën e qarkullimit rrugor, bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikëqyrjen e sigurisë, rendit e të qetësisë publike në raste të aktiviteteve të ndryshme përfshi sportive, përgjatë vijës bregdetare publike dhe në zonat çlodhëse, për sigurinë në det, plazhe; monitoron respektimin e ndarjes së hapësirës së plazhit; mbështet strukturat përgjegjëse të bashkisë për strehimin social, strukturat e taksave vendore dhe çdo investim të bashkisë.

Mbikëqyre respektimin e normave të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, bashkërendon punën me strukturat përkatëse kur konstaton veprimtari të paligjshme për mjedisin, natyrën, pyjet, biodiversitetin dhe florën e faunën e egër, të kontrollit mbi gjuetinë, veprimtarinë e peshkimit,

mbrojtjen e liqeneve; normat për nivelin kufi të zhurmës së lejuar;

Në fushën e veprimtarisë ekonomike dhe tregtare, ambulante, në vende publike; mbikëqyr përdorimin e qeseve plastike mbajtëse të ndalauara, vendosjen e materialeve reklamuese të pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar drejtuar të miturve; siguron respektimin e normave ligjore në lidhje me ndalimin e pirjes së duhanit në mjetet e transportit publik, mjediset e përbashkëta, banesat me bashkëpronësi të detyrueshme.

Në fushën e ruajtjes së hapësirës publike, zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike, ndërtimet e kundërligjshme, për funksionimin e shërbimit publik të varrimit dhe për administrimin e varrezave në territorin e juridiksionit të bashkisë;

Garanton zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi afishimin e materialeve propagandistike në vendet jashtë përcaktimeve të bëra, duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore.

Arësye të tjera:

Rritja e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake është parashikuar strategjikisht edhe duke ju referuar politikës për rritjen e parametrave të sigurisë në komunitet, përcaktuar kjo në mënyrë indirekte nga “Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021–2026” dhe të planit të veprimit 2021–2023, miratuar me vendim nr. 1139, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave.

Efektiviteti i menaxhimit të qarkullimit rrugor.

Ndryshimet në strukturën e Policisë Bashkiake synojnë krijimin e një edukate dhe sjelljeje korrekte të qytetarëve në drejtimin dhe përdorimin e qarkullimit të automjeteve, si dhe ndërgjegjësimin e publikut për sjelljen në rrugë. Angazhimi i strukturave përgjegjëse të PB në monitorimin dhe menaxhimin e trafikut, duhet të jetë pjesë e punës koordinuese të strukturave të policisë në interes të rritjes së sigurisë rrugore.

Për këtë qëllim brenda strukturës së PB duhet të funksionojë Qendra e Menaxhimit të Trafikut në kohë reale, strukturë që do të bashkërendojë punën me Policinë e Qarkullimit Rrugor. Qendra do të ketë numër minimal prej 3 punonjësish, të trajnuar në vijim për problemet e koordinimit të qarkullimit rrugor, menaxhimin e simeve dixhitale off/online që do të mundësojnë si kontrollin automatik me anë të sistemeve automatik inteligjent për shpejtësinë etj., për shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor si dhe krijimin e kontrollit të bankës së të dhënave për shkelësit, përsëritësit dhe deri te “Piratët e Rrugës”, etj..

Kontrolli dhe administrimi i territorit.

Kontrolli i plotë i territorit, në funksionon të garantimit të zbatimit të ligjshmërisë, është një detyrë e rëndësishme e PB dhe strukturave të tjera me përgjegjësi në këtë drejtim.

Menaxhimi i vijës bregdetare dhe të hapësirave të plazhit, të gjitha zonave turistike në territorin e Bashkisë Shkodër tregojnë për mundësitë dhe hapësirat e shumta që ekzistojnë për një administrim më të mirë të territorit, kjo do të mundësohet nëpërmjet forcimit të strukturës së PB.

Sfidat.

Problemet të cilat ndikojnë në fushën e sigurisë, qetësisë, rendit në komunitet, janë një ndër sfidat kryesore për aktuale për Bashkinë Shkodër.

Siguria dhe ruajtja e rendit publik mund të përmirësohen nëpërmjet ndërmarrjes së masave të mëposhtme:

- sigurimit të ligjshmërisë në territor dhe një marrëdhënie të re me biznesin, komunitetin në tërësi dhe shoqërinë civile në funksion të garantimit të sigurisë së qytetarëve;
- përmirësimit të menaxhimit të qarkullimit rrugor, me synim rrjedhshmërinë e trafikut rrugor dhe minimizimin e aksidenteve;
- parandalimit dhe përballimit të situatave emergjente;
- marrjes së përgjegjësisë, llogaridhënies dhe koordinimit më të mirë me strukturat e tjera ligjzbatuese.

Me decentralizimin, si dhe konceptin e policimit në komunitet, siguria publike ka pësuar një ridimensionim në mënyrën e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit, e cila tashmë synon një përfshirje jo vetëm të institucioneve qendrore por edhe vendore, të cilat kanë detyrime për çështjet e rendit publik.

Siguria është një e mirë publike aq e rëndësishme dhe e ndërlikuar, sa që ajo nuk mund të krijohet vetëm me kapacitetet e kufizuara të Policisë Bashkiake, kështu bashkëpunimi me qytetarët është parakusht i padiskutueshëm që do të mundësohet me krijimin e pikave lidhëse me qytetarët në terren, nëpërmjet numrit të emergjencës që do të krijohet, faqeve ëeb, rrjeteve sociale, prezantimeve të ndryshme duke filluar në armin parauniversitar, në komunitete, etj..

Me qëllim arritjen e një standardi të policimit, ndër të tjera duhet të bëhet dhe sigurimi i numrit minimal të punonjësve për të mbuluar me shërbime operationale në terren: “hot-spotet” e krijuara në vite në cdo fushë, njësitë administrative jo vetëm të zonave urbane por edhe të zonave rurale që duhet të mbulohen me patrullime në terren.

Praktikat e vendeve europiane etj.:

Përcaktojnë teorikisht dhe praktikisht një numër minimal prej 0.62 policë bashkiak për 1000 banorë për komunat me deri në 10 000 banorë, numër ky që rritet në varësi të popullsisë dhe dendësisë duke ju referuar qendrave të banuara shkon deri në 1.68 punonjës policie bashkiak për 1000 banorë në komunat me mbi 100 000 banorë dhe ka tendencë rritje në komunat me popullsi më të dendur. Megjithatë numri përcaktohet në bazë të specifikave të vendeve, popullsisë, terrenit etj..

Mund të përmendim Italinë ku numri varion ne Verona 1,15 punonjës /1000 banorë, Bari me 1,73 punonjës/1000 banorë deri në numrin më të madh që është në Firenze në raportin 2,35 punonjës/1000 banorë.

Ja vlen që të përmendim e sqarojmë se Policia Bashkiake e Tiranës tashmë e konsoliduar ka një strukturë organike me 600 punonjës në një raport popullsisë rreth 850.000 banorë, në këtë raport i takon që sipas popullsisë prej rreth 211.000 banorë të Bashkisë Shkodër duhet të ketë një numër organik prej 148 punonjësish, kostot për këtë janë të pamundura dhe të papërbalueshme sot për sot në raport me buxhetin real të bashkisë.

Konkluzion:

Relacioni i mësipërm ju shpjegon domosdoshmërinë jo vetëm të rritjes së numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake, por edhe nevojës për reformim/ristrukturim të thellë dhe efikas për një konceptim të ri të Policisë Bashkiake Shkodër në formën e saj materiale dhe lëndore.

Sa me sipër, Shtesa prej 15 punonjës kërkohet me qëllim realizimin e detyrave të policice bashkiake në zbatim të ligjit specifik të tij

Për sa parashtroam, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë projekt vendimin paraqitur;

Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Duke ju falenderuar!


KRYETAR

Benet BECI

Me vendim delegimi

Zv.KRYETARI

Osip HILKATI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. 15PPP Prot

Shkodër, më 3007.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendim “Për një ndryshim në VKB nr.55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR


Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2024

Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh”, ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar; ligji nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ligji nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”; VKB nr. 54, datë 29.12.2023 “Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 ...; VKB nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në numrit total të punonjësve të bashkisë Shkodër, sipas tabelës nr.11, pjesë përbërese e këtij vendimi.
2. Fondi I pagave për punonjesit shtesë të bashkisë Shkodër përballohet nga buxheti I bashkisë viti 2024.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



ZV/KRYETAR

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Be. B. Keshi

Drejtoria burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve mbështetëse,

et. Geroj

Drejtori Juridike

B. Leqepo

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar

Genë Hoxha

Drejtoria e Analizës dhe e Programimit
Buxhetor

Gjeras

Drejtoria e Financës

Blerta Njedy

Njësia e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile

Leela Dalmiraj

Policia Bashkiake

Etan Myrtaj

Ishte
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2024


Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri i punonjësve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	583	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	126	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	228	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	42	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		979	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
TOTALI		999	20

Bëhet
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2024

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri i punonjësve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	598	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	126	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	228	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	42	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		994	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
TOTALI		1,014	20





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

RELACION

Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh”, ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar; ligji nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ligji nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”; VKB nr. 54, datë 29.12.2023 “Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 ...; VKB nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026; Bashkia Shkodër paraqet për shqyrtim relacion për:

1. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve të Sektori i Emergjencave Civile, nga 3 nëpunës në 8 nëpunës duke krijuar Drejtorinë e Emergjencave Civile nga Njësi e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile që është aktualisht,
2. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake të Bashkisë Shkodër nga 39 aktualisht në 49 punonjës.

I.Kërkesa për rritjen e numrit të nëpunësve tek emergjencat civile vjen si rezultat i nevojës për të kryer shërbime cilësore, pasi në ligjin 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, në nenin 30 caktohen disa detyra shumë të rëndësishme për bashkitë në kuadër të mbrojtjes civile.

Në ndryshim nga ligji i mëparshëm nr.8756, datë 26.03.2001, “ Për emergjencat Civile”, i ndryshuar, në ligjin 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, bashkitë marrin rol kryesor në parandalimin dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, duke filluar me hartimin e tre dokumentave strategjikë siç janë a) Dokumenti i Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë, b) Dokumenti i Strategjisë së Zvoglimit të Riskut nga Fatkeqësitë dhe c) Plani Vendor I

Emergjencave Civile, deri te kryerja e investimeve parandaluese, mbrojtëse dhe reabilituese nga fatkeqësitë.

Gjithashtu në nenin 65 të këtij ligji, “**Buxheti i bashkive**”, sanksionon që bashkitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 përqind të totalit të buxhetit vjetor, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.

Nga raporti i konsoliduar i Agjencia Kombëtare të Mbrojtjes Civile për Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Shqipëri, qarku i Shkodrës karakterizohet nga një risk shumë i lartë nga përmbytjet dhe zjarret masive dhe bën pjesë në zonat e vendit që kanë nivel risku mesatar në të lartë nga fatkeqësitë. Vetëm në vitet 2018 dhe 2021 janë përmbytur **4593** ha sipërfaqe me kultura bujqësore, në vlerë dëmi **1,112,636,459** (një miliard, e njëqind e dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë lekë).

Edhe në fushën e emergjencave në lidhje me zjarret, bashkia Shkodër ka një situatë të rënduar, pasi vetëm gjatë vitit 2023, është ndërhyrë në 341 raste zjarresh dhe në datë 14 Qershor kemi patur një zjarr në lagjen Perash, me pasoja të rënda në pronën e qytetarëve.

Në këto kushte Struktura e Emergjencave Civile ka nevojë për staf shtesë dhe të kualifikuar, pasi veç të tjerash kjo strukturë ka detyrim ligjor vlerësimin e dëmeve që ju shkaktohen qytetarëve për jetën dhe banesat e tyre, prej fatkeqësive.

Shtesa në punonjës kërkohet që shërbimet e emergjencave civile të kryejnë në mënyrë cilësore detyrimet që i ngarkohen me ligji specifik.

II. Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake bazohet në faktin se Policia Bashkiake është strukturë në varësi të bashkisë, e cila angazhohet në zbatimin e detyrave që i ngarkon ligji organik për vetëqeverisjen vendore, vendimet e këshillit bashkiak, si dhe akte të tjera të nxjerra nga kryetari i bashkisë. Referuar parashikimeve të këtij ligji, Policia Bashkiake ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, në mbarëvajtjen e punëve publike, mirë administrimit të hapësirave publike në territorin e juridiksionit të saj, zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve të nxjerra nga organi përfaqësues dhe ekzekutiv i bashkisë.

Duke marrë në konsideratë rolin e saj në ndihmë të ushtrimit të funksioneve të organeve dhe strukturave të bashkisë, situatën problematike të krijuar ndër vite tashmë puna e Policisë Bashkiake Shkodër ka marrë një dimension edhe më të gjerë, ka krijuar një vijueshmëri në proçese pune me proçedura të standartizuara dhe sistematike që bën të domosdoshëm shtimin e numrit të punonjësve në funksion të mbarëvajtjes normale të punës dhe efektivitetit të detyrave të ushtruara nga kjo strukturë.

Konkretisht përse duhet të shtohet numri organik i strukturës së Policisë Bashkiake?

Arësyeja I:

Numri i punonjësve të PB aktualisht në vitin 2024 është 39 (5 janë roje objektit të bashkisë), referuar organikave të vitit 2002 struktura ishte 37, ndërkohë me kalimin e viteve kemi dendësi në rritje të popullsisë në qytetin Shkodër, njësinë administrative Velipojë, rritje të territorit në kilometër katror dhe në rrugë automobilistike, rritje të bizneseve të regjistruara, rritje të turizmit në të gjithë territorin duke përfshirë pikat turistike masive të Velipojës, Shirokës dhe Thethit, etj..

Me miratimin e ligjit organik nr 139/2015 “Për vetë qeverisjen Vendore” popullsia, territori, asetet e ish komunave janë bërë pjesë e Bashkisë Shkodër ndërsa strukturat e Policive Komunale janë shkurtuar duke e lënë strukturën e punonjësve të PB me vetëm 24 punonjës, deri në muajin Shtator 2023.

Për t’ju përgjigjur në kohë problematikave të qytetarëve, bashkisë si institucion dhe jo vetëm, për rendin e sigurinë publike, logjikisht duhet shtuar numri i punonjësve të PB ku në këtë numër përfshihen dhe punonjësit administrativ që nuk kryejnë funksione operacionale.

Arësyeja II:

Në ligjin e vjetër detyrat për Policinë Bashkiake ishin 12 ndërsa aktualisht ato janë mbi mbi dyfishuar duke u bërë 28 të ndara në 7 fusha, më poshtë mund të përmendim:

detyra për emergjencat civile, në fushën e qarkullimit rrugor, bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikëqyrjen e sigurisë, rendit e të qetësisë publike në raste të aktiviteteve të ndryshme përfshi sportive, përgjatë vijës bregdetare publike dhe në zonat çlodhëse, për sigurinë në det, plazhe; monitoron respektimin e ndarjes së hapësirës së plazhit; mbështet strukturat përgjegjëse të bashkisë për strehimin social, strukturat e taksave vendore dhe çdo investim të bashkisë.

Mbikëqyre respektimin e normave të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, bashkërendon punën me strukturat përkatëse kur konstaton veprimtari të paligjshme për mjedisin, natyrën, pyjet, biodiversitetin dhe florën e faunën e egër, të kontrollit mbi gjuetinë, veprimtarinë e peshkimit,

mbrojtjen e liqeneve; normat për nivelin kufi të zhurmës së lejuar;

Në fushën e veprimtarisë ekonomike dhe tregtare, ambulante, në vende publike; mbikëqyr përdorimin e qeseve plastike mbajtëse të ndalauara, vendosjen e materialeve reklamuese të pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar drejtuar të miturve; siguron respektimin e normave ligjore në lidhje me ndalimin e pirjes së duhanit në mjetet e transportit publik, mjediset e përbashkëta, banesat me bashkëpronësi të detyrueshme.

Në fushën e ruajtjes së hapësirës publike, zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike, ndërtimet e kundërligjshme, për funksionimin e shërbimit publik të varrimit dhe për administrimin e varrezave në territorin e juridiksionit të bashkisë;

Garanton zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi afishimin e materialeve propagandistike në vendet jashtë përcaktimeve të bëra, duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore.

Arësye të tjera:

Rritja e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake është parashikuar strategjikisht edhe duke ju referuar politikës për rritjen e parametrave të sigurisë në komunitet, përcaktuar kjo në mënyrë indirekte nga “Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021–2026” dhe të planit të veprimit 2021–2023, miratuar me vendim nr. 1139, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave.

Efektiviteti i menaxhimit të qarkullimit rrugor.

Ndryshimet në strukturën e Policisë Bashkiake synojnë krijimin e një edukate dhe sjelljeje korrekte të qytetarëve në drejtimin dhe përdorimin e qarkullimit të automjeteve, si dhe ndërgjegjësimin e publikut për sjelljen në rrugë. Angazhimi i strukturave përgjegjëse të PB në monitorimin dhe menaxhimin e trafikut, duhet të jetë pjesë e punës koordinuese të strukturave të policisë në interes të rritjes së sigurisë rrugore.

Për këtë qëllim brenda strukturës së PB duhet të funksionojë Qendra e Menaxhimit të Trafikut në kohë reale, strukturë që do të bashkërendojë punën me Policinë e Qarkullimit Rrugor. Qendra do të ketë numër minimal prej 3 punonjësish, të trajnuar në vijim për problemet e koordinimit të qarkullimit rrugor, menaxhimin e simeve dixhitale off/online që do të mundësojnë si kontrollin automatik me anë të sistemeve automatik inteligjent për shpejtësinë etj., për shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor si dhe krijimin e kontrollit të bankës së të dhënave për shkelësit, përsëritësit dhe deri te “Piratët e Rrugës”, etj..

Kontrolli dhe administrimi i territorit.

Kontrolli i plotë i territorit, në funksionon të garantimit të zbatimit të ligjshmërisë, është një detyrë e rëndësishme e PB dhe strukturave të tjera me përgjegjësi në këtë drejtim.

Menaxhimi i vijës bregdetare dhe të hapësirave të plazhit, të gjitha zonave turistike në territorin e Bashkisë Shkodër tregojnë për mundësitë dhe hapësirat e shumta që ekzistojnë për një administrim më të mirë të territorit, kjo do të mundësohet nëpërmjet forcimit të strukturës së PB.

Sfidat.

Problemet të cilat ndikojnë në fushën e sigurisë, qetësisë, rendit në komunitet, janë një ndër sfidat kryesore për aktuale për Bashkinë Shkodër.

Siguria dhe ruajtja e rendit publik mund të përmirësohen nëpërmjet ndërmarrjes së masave të mëposhtme:

- sigurimit të ligjshmërisë në territor dhe një marrëdhënie të re me biznesin, komunitetin në tërësi dhe shoqërinë civile në funksion të garantimit të sigurisë së qytetarëve;
- përmirësimin të menaxhimit të qarkullimit rrugor, me synim rrjedhshmërinë e trafikut rrugor dhe minimizimin e aksidenteve;
- parandalimit dhe përballimit të situatave emergjente;
- marrjes së përgjegjësisë, llogaridhënies dhe koordinimit më të mirë me strukturat e tjera ligjzbatuese.

Me decentralizimin, si dhe konceptin e policimit në komunitet, siguria publike ka pësuar një ridimensionim në mënyrën e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit, e cila tashmë synon një përfshirje jo vetëm të institucioneve qendrore por edhe vendore, të cilat kanë detyrime për çështjet e rendit publik.

Siguria është një e mirë publike aq e rëndësishme dhe e ndërlikuar, sa që ajo nuk mund të krijohet vetëm me kapacitetet e kufizuara të Policisë Bashkiake, kështu bashkëpunimi me qytetarët është parakusht i padiskutueshëm që do të mundësohet me krijimin e pikave lidhëse me qytetarët në terren, nëpërmjet numrit të emergjencës që do të krijohet, faqeve ëeb, rrjeteve sociale, prezantimeve të ndryshme duke filluar në arsimin parauniversitar, në komunitete, etj..

Me qëllim arritjen e një standardi të policimit, ndër të tjera duhet të bëhet dhe siguri i numrit minimal të punonjësve për të mbuluar me shërbime operacionale në terren: “hot-spotet” e krijuara në vite në cdo fushë, njësitë administrative jo vetëm të zonave urbane por edhe të zonave rurale që duhet të mbulojnë me patrullime në terren.

Praktikat e vendeve europiane etj.:

Përcaktojnë teorikisht dhe praktikisht një numër minimal prej 0.62 policë bashkiak për 1000 banorë për komunat me deri në 10 000 banorë, numër ky që rritet në varësi të popullsisë dhe dendësisë duke ju referuar qendrave të banuara shkon deri në 1.68 punonjës policie bashkiak për 1000 banorë në komunat me mbi 100 000 banorë dhe ka tendencë rritje në komunat me popullsi më të dendur. Megjithatë numri përcaktohet në bazë të specifikave të vendeve, popullsisë, terrenit etj..

Mund të përmendim Italinë ku numri varion ne Verona 1,15 punonjës /1000 banorë, Bari me 1,73 punonjës/1000 banorë deri në numrin më të madh që është në Firenze në raportin 2,35 punonjës/1000 banorë.

Ja vlen që të përmendim e sqarojmë se Policia Bashkiake e Tiranës tashmë e konsoliduar ka një strukturë organike me 600 punonjës në një raport popullsie rreth 850.000 banorë, në këtë raport i takon që sipas popullsisë prej rreth 211.000 banorë të Bashkisë Shkodër duhet të ketë një numër organik prej 148 punonjësish, kostot për këtë janë të pamundura dhe të papërbalueshme sot për sot në raport me buxhetin real të bashkisë.

Konkluzion:

Relacioni i mësipërm ju shpjegon domosdoshmërinë jo vetëm të rritjes së numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake, por edhe nevojës për reformim/ristrukturim të thellë dhe efikas për një konceptim të ri të Policisë Bashkiake Shkodër në formën e saj materiale dhe lëndore.

Sa me sipër, Shtesa prej 15 punonjës kërkohet me qëllim realizimin e detyrave të policice bashkiake në zbatim të ligjit specifik të tij

Për sa përshtruar, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë projekt vendimin paraqitur;

Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Duke ju falenderuar!

